


Pjesa A - Çdo përgjigje e saktë vlerësohet me 3 pikë

- # 1. Sa më e lartë që të jetë shkalla në podium aq më i lartë është rangimi në garën e vrapimit. Cili garues doli i treti?



- (A) A (B) B (C) C (D) D (E) E


- # 2. Në figurat vijuese, pika e paraqet numrin 1 dhe vija e paraqet numrin 5. Për shembull,  e paraqet numrin 8. Cila figurë e paraqet numrin 12?

- (A)  (B)  (C)  (D)  (E) 

- # 3. Dje ishte e dielë. Çfarë dite është nesër?

- (A) E martë (B) E enjte (C) E mërkurë (D) E hënë (E) E shtunë


- # 4. Në kopertinën e një libri janë dy vrima. Kur libri është i hapur, ai duket si në vijim:




Cilat figura i sheh Ylli përmes vrimave kur ai e mbyll librin?

- (A)  (B)  (C) 
(D)  (E) 


- # 5. Krenarja e pret një pjesë si në vijim , nga figura e mëposhtme.



Cilën pjesë mund të merr ajo?

- (A)  (B)  (C)  (D)  (E) 


8. Cili numër duhet të zëvendësojë pikëpyetjen pasi që të kryhen saktë të gjitha llogaritjet?



- (A) 4 (B) 5 (C) 6 (D) 7 (E) 8

Pjesa B - Çdo përgjigje e saktë vlerësohet me 4 pikë


9. Linda i ngjiti 3 fotografi në rresht në tabelë duke përdorur 8 gjilpëra.




Petriti dëshiron t'i ngjes 7 fotografi në të njëjtën mënyrë. Sa gjilpëra i nevojiten atij?

- (A) 14 (B) 16 (C) 18 (D) 22 (E) 26

10. Elirdi dëshiron të heq një katror nga forma:




Sa nga këto forma mund t'i formojë?




- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5


11. Gjashtë shirita kanë formuar modelin që tregohet në figurë.



Si duket modeli nga prapa?



12. Pesha e qenit është numër i plotë. Sa peshon një qen?



- (A) 7 kg (B) 8 kg (C) 9 kg (D) 10 kg (E) 11 kg

13. Sara ka 16 rruaza të kaltërta. Ajo mund t'i këmbejë rruazat në dy mënyra:

3 rruaza të kaltërta për 1 rruazë të kuqe ose 2 rruaza të kuqe për 5 rruaza të gjelbërta.

Sa është numri maksimal i rruazave të gjelbërta që ajo mund të marrë?

- (A) 5 (B) 10 (C) 13 (D) 15 (E) 20


14. Samiu dëshiron të shkruajë secilën nga shifrat 2, 0, 1 dhe 9 në njërin nga katrorët në vijim.



Ai dëshiron që të marrë shumën më të madhe të mundshme. Cilën shifër mund të shënojë ai në vend të pikëpyetjes?

- (A) Ose 0 ose 1 (B) Ose 0 ose 2 (C) Vetëm 0 (D) Vetëm 1 (E) Vetëm 2

15. Gota e mbushur plotë me ujë peshon 400 gram. Gota e zbrazët peshon 100 gram.




400 g 100 g ?


Sa gram peshon gota e mbushur me ujë deri në gjysmë?

- (A) 150 (B) 200 (C) 225 (D) 250 (E) 300


16.




Së bashku
kushtojmë 5 centë



Së bashku
kushtojmë 7 centë



Së bashku
kushtojmë 10 centë



Sa kushtojmë
së bashku

- (A) 8 centë (B) 9 centë (C) 10 centë (D) 11 centë (E) 12 centë

Pjesa C - Çdo përgjigje e saktë vlerësohet me 5 pikë

17. Secilës figurë i përgjigjet një numër i ndryshëm. Shuma e të tre numrave në secilin rresht tregohet djathtas rreshtit.


			15
			12
			16



Sa është vlera e ?

- (A) 2 (B) 3 (C) 4 (D) 5 (E) 6

18. Arta përdori 32 katrorë të bardhë për të bërë kornizën e një pikturë me dimensionet 7×7 .




Sa katrorë të bardhë i nevojiten asaj për kornizën e pikturës me dimensione 10×10 ?

- (A) 36 (B) 40 (C) 44 (D) 48 (E) 52

19. Faqet e një libri janë numëruar me 1, 2, 3, 4, 5 e kështu me radhë. Shifra 5 paraqitet saktësisht 16 herë. Sa është numri maksimal i faqeve që mund të ketë ky libër?

- (A) 59 (B) 64 (C) 66 (D) 74 (E) 80

20. Korridorin ka dimensionet që tregohen në figurë. Një mace ecën nëpër vijën e ndërprerë përgjatë mesit të korridorit.



Sa metra ka ecur macja?

- (A) 63 (B) 68 (C) 69 (D) 71 (E) 83

21. Në një park gjenden 15 kafshë: lopë, mace dhe kengura.

E dimë që saktësisht 10 nga kafshët nuk janë lopë dhe saktësisht 8 nga kafshët nuk janë mace.


Sa kengura gjenden në park?

- (A) 2 (B) 3 (C) 4 (D) 8 (E) 10

22. Merita ka 9 trekëndësha të vegjël: 3 prej tyre janë me ngjyrë të kuqe (K), 3 janë me ngjyrë të verdhë (V) dhe 3 janë me ngjyrë të bardhë (B).

Ajo dëshiron të formojë një trekëndësh të madh duke i bashkuar 9 trekëndëshat e vegjël ashtu që çdo dy trekëndësha të vegjël që kanë brinjën e përbashkët të jenë me ngjyra të ndryshme.

Merita i ka vendosur disa trekëndësha të vegjël si tregohet në figurë.



Cila fjali është e saktë pasi që Merita i vendosi të gjithë trekëndëshat?

- (A) 1 - i verdhë dhe 3 - i kuq (B) 1 - i bardhë dhe 2 - i kuq (C) 1 dhe 3 janë të kuq
(D) 5 - i kuq dhe 2 - i verdhë (E) 1 dhe 3 janë të verdhë

23. Njëri nga pesë fëmijët: Artani, Bardhi, Durimi, Era dhe Fjolla e ka ngrënë një ëmbëlsirë.

Artani tha: "Unë nuk e kam ngrënë ëmbëlsirën."

Bardhi tha: "Unë e kam ngrënë ëmbëlsirën."

Durimi tha: "Fjolla nuk e ka ngrënë ëmbëlsirën."


Era tha: "Unë nuk e kam ngrënë ëmbëlsirën."

Fjolla tha: "Artani e ka ngrënë ëmbëlsirën."


Vetëm njëri nga fëmijët po gënjen. Cili e ka ngrënë ëmbëlsirën?

- (A) Artani (B) Bardhi (C) Durimi (D) Era (E) Fjolla

24. Ermiri filloi të varte peshqirët duke përdorur dy kapëse për secilin peshqir, ashtu siç tregohet në figurën 1.



Ai e kuptoi se nuk kishte kapëse të mjaftueshme dhe filloi t'i varte peshqirët siç tregohet në figurën 2.



Ai gjithsej i varti 35 peshqirë dhe përdori 58 kapëse.

Sa peshqirë i varti Ermiri në mënyrën që tregohet në figurën 1?

(A) 12

(B) 13

(C) 21

(D) 22

(E) 23